



Datë: 02.10.2025
Numër Protokolli: 6531/2025

A.nr.975/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.975/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.975/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, G.H, më datë 27.05.2025 përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016741, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar për Regjistrim Civil*”, në Drejtoratin e Pajisjes me Dokumente-ARC, në Ferizaj, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku më shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.975/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë me 14.02.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016741, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar për Regjistrim Civil*”, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend pune, në Ferizaj, i hapur për aplikim nga data 21.03.2025 deri më datën 19.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (52) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, i njëjti i është nënshtruar edhe fazave të vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arrit 55.6 pikë ndërsa në intervistën me gojë ka arrit 7.4 pikë, në total ankuesi ka grumbulluar 63 pikë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë Punëve të Brendshme, më datë 15.05.2025 ka publikuar Njoftimin me numër 923 për shpalljen e rezultatit përfundimtar, nga i cili njoftim rezulton se si candidate e suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur H.K-Sh me 93.8 pikë.

Pas publikimit të Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar të datës 15.05.2025, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor se sipas ankuesit organi i punësimit me rastin e publikimit të Njoftimit datës 06.05.2025 lidhur me njoftimin e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim emri i ankuesit nuk figuron, edhe pse i njëjti e ka kaluar testin dhe ka arritur pikët e mjaftueshme për tu intervistuar me gojë. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, të kërkoj sqarime nga MPB dhe ARC, e gjithashtu të anuloj në tërësi procedurën e rekrutimit sipas konkursit me reference RN00016741 në tërësi.

Duke qenë së kundër procedurës me numër reference RN00016741, kishte parashtruar ankesë edhe A.A, si candidate në procedurën e njëjtë, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.1139/2025, të datës 15.08.2025, ka anuluar Njoftimin e Nr.923, të datës 15.05.2025, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, ndërsa, çështjen e ka kthyer në fazën e verifikimit paraprak. Andaj, referuar këtyre rrethanave ligjore dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.975/2025, të datës 27.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1139/2025, të datës 15.08.2025. Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, vlerëson së objekti i ankesës A.nr.975/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.975/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, G.H;*
- *Njësisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*